Funksionet në fushën e sherbimeve sociale

Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:

- Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor,për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara,viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

- Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.

- Krijimin në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale,të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.